

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria**

me zgjidhje

P10

Data 25/06/2016

Detyra 1

(a) Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Beri-Audit, përgjegjës për auditimin e Elkofar, kompani që prodhon pllaka elektronike dhe i shet tek prodhuesit e panelëve të energjisë diellore. Kjo është hera e parë që po menaxhoni një klient të auditimit, pasi që keni marr detyrën nga Mic Boletini, menaxheri i mëparshëm. Planifikimi i auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015 është duke filluar dhe ju keni pranuar një email nga Aurora L., partnere e auditimit (auditore e angazhimit) të Elkofar:

Për: Menaxherin e auditimit

Nga: Aurora L, partnere, Beri-Audit

Tema: planifikimi i auditimit në Elkofar

Përshëndetje

Jam e informuar se tash së voni jeni takuar me Arben Istrefin, drejtor financiar i kompanisë Elkofar. Duke përdorur informatat nga takimi juaj, do të doja të përgatitni një letër me shënime në të cilën do të:

- (i) **Vlerësoni rreziqet e binzesit me të cilat ballafaqohet Elkofar; (12 pikë)**
- (ii) **Identifikoni dhe shpjegoni KATËR rreziqe të anomalive materiale që duhet të konsiderohen gjatë planifikimit të auditimit; dhe (8 pikë)**
- (iii) **Diskutoni çështjet etike dhe rekomandoni veprimet e duhura që duhet të ndërmerren nga firma e auditimit. (10 pikë)**

Ju falemnderit

Komentet e Arben Istrefit gjatë takimit tuaj:

Vështrim i përgjithshëm mbi kompaninë

Aktiviteti kryesor i biznesit të Elkofar mbetet prodhimi i pllakave elektronike. Njëri nga materialet kyçe që përdoret në prodhimin e pllakave janë telat e bakrit të cilat importohen. Si një masë për zvogëlimin e kostove, në maj të vitit 2015, është nënshkruar një kontratë me një furnitor jashtë vendit dhe tani të gjitha kabllot e bakrit importohen sipas kësaj kontrate të furnizimit. Blerjet bëhen me valutë të huaj, por kompania nuk përdor kontrata forward (për fiksimin e çmimit dhe datës) lidhur me këto importe. Elkofar ka dy fabrika të prodhimit, njëra prodhon produkte për eksport ndërsa tjetra për tregun vendor. Rreth gjysma e produkteve të kompanisë eksportohen, mirëpo tregu i eksportit është duke u ballafaquar me vështirësi për shkak të konkurrencës nga prodhues të lirë nga jashtë. Shumica e shitjeve vendore bëhen përmes kontratave me rreth 20 konsumatorë.

Zhvillimet e fundit

Në fillim të dhejtorit 2015, fabrika që prodhon për tregun vendor kishte ndërprerë prodhimin për një javë. Një numër i konsumatorëve kishin kthyer mallrat, duke u ankuar se kishte defekte në pllakat elektronike. Gjatë inspektimit, është zbuluar se bakri që përdoret në pllaka elektronike është ndryshkur prandaj nuk mund të përdoret. Ky ndryshk është vështirë për tu vërejtur pasi që nuk mund të shihet me sy prandaj mbështeten në testim elektrik. Të gjithë konsumatorët janë kontaktuar menjëherë dhe nëse ishte e nevojshme produktet janë tërhequr dhe zëvendësuar. Bakri i ndryshkur që ka mbetur në stoqe është identifikuar dhe është ndarë nga bakri tjetër. Së voni ka filluar linja e re e prodhimit e cila do të sigurojë se kompania përmbushë kërkesat e reja rregullatore që ndalon përdorimin e disa kimikateve, e cila rregullore hyn në fuqi në shkurt të vitit 2016. Në qershor 2015, është negociuar një hua nga banka prej €30 milion me një interes 4%. Qëllimi kryesor i kredisë ishte financimi i shpenzimeve kapitale të nevojshme për linjën e re të prodhimit. €2.5 milion e huasë përfaqëson një mbitërheqje e cila ishte konvertuar në financim afatgjatë.

Çështje tjera

Disa nga drejtorët ekzekutiv të Elkofar si dhe shefi i kontabilitetit kanë ikur nga kompaani në shtator 2015, për të themeluar një kompani të specializuar në riciklimin e pajisjeve të vjetra elektronike. Kjo kompani e re nuk konsiderohet konkurrencë e Elkofar. Drejtorët u larguan në mënyrë miqësore nga kompania dhe ndërkohë Elkofar kishte rekrutuar drejtorët tjerë për të zëvendësuar këto pozita. Njëri nga menaxherët e auditimit të Beri-Audit, Míc Boletini, është duke u intervistuar nga kompania Elkofar për pozitën e shefit të kontabilitetit. Mici është kandidat i mirë për këtë pozitë pasi që ka zhvilluar njohuri të mirë për Elkofar gjatë kryerjes së punës si menaxher i auditimit në vitin e kaluar. Në takimin e fundit të bordit të Elkofar është diskutuar tarifa e auditimit. Anëtarët e bordit shprehën shqetësimin e tyre për tarifën e lartë të auditimit duke konsideruar humbjen e kompanisë këtë vit. Anëtarët e bordit janë të interesuar të dinë nëse auditimi mund të kryhet duke u bazuar në tarifa kontingjente.

Informatat financiare të ofruar nga kompania të pasqyrës së ta ardhurave draft për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015

	2015 draft '000	2014 aktuale '000
Të hyra	12,500	13,800
Kosto operative	(12,000)	12,800
Fitimi operativ	500	1,000
Kosto financiare	(800)	(800)
Fitimi/(humbja) e vititi	(300)	200

Drafti i pasqyrës së pozicionit financiar nuk është përgatitur ende por Arbeni thekson se pasuria gjithsej me 31 dhjetor është €180 milion dhe paraja në bankë është €130,000. Bazuar në shifrat draft, koeficienti qarkullues është 1.1 dhe koeficienti i shpejtësisë është 0.8.

Kërkohet: Përgjigjuni emialit të partnerit të auditimit.

(Gjithsej 30 pikë)

Shënim: ndarja e pikëve është paraqitur në emailin e partnerit të auditimit më sipër.

Zgjidhja

Hyrje

Kjo letër paraqet rreziqet biznesore të kompanisë dhe identifikon dhe shpejgon katër rreziqe të anomalive materiale që duhet të konsiderohen në fazën e planifikimit të auditimit të kompanisë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015. Përveç kësaj janë paraqitur edhe çështjet etike dhe veprimet e rekomanduara.

(i) Rreziqet biznesore

Mallrat e importuara – luhatjet në këmbimet valutore

Elkofar mbështetet në përbërës të prodhimit që importohen nga jashtë. Kjo e ekspozon kompaninë ndaj luhatjes së çmimie për shkak të normës së këmbimit valutator. Kompania nuk përdor kontrata forward për të zvogëluar këtë rrezik që mund të mos jetë strategji e mençur për një biznes që mbështetet në import. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutator po ashtu mund të shkaktojnë luhatjen në fitimin e kompanisë.

Mallrat e importuara – çështjet me transportin

Mbështetja e madhe në import do të thotë edhe rritje të kostos së transportit. Gjithashtu mund të ketë pengesa në probleme me avionë. Si rezultat mund të ketë mungesë të stoqeve një kohë dhe kështu pengesa në prodhim. Përveç nëse kompania mban nivel të arsyeshëm të stoqeve për të adresuar vështirësitë me transportin, kjo mund të shkaktojë problem me reputacionin.

Mbështetja në një furnitor të vetëm

I gjithë teli i bakrin vjen nga një furnitor jashtë vendit. Ky nivel i mbështetjes është tepër me rrezik dhe çfardo pengese nga ana e furnitorit do të reflektohet edhe në kompaninë Lenjani.

Çështjet me kontrollin e cilësisë

Që nga përzgjedhja e furnitorit, kompania është duke u ballafaquar me cilësi të dobët të telave të bakrit që mund të rezultojë me humbjen e konsumatorëve. Ndryshimi i furnitorit mund të ketë qënë rezultat i zvogëlimit të kostove, mirëpo zgjidhja e problemit të cilësisë mund të jetë më problematike për shkak të largësisë me furnitorin. Mund të ketë kosto shtesë për të siguruar cilësinë e duhur për kosto e testimit shtesë. Marzha operative e kompanisë tashmë është mjaft e ulët vetëm 4% (2014 – 7.2%), prandaj kosto shtesë do ta zvogëlojë këtë marzhë edhe më tutje.

Teknologjia e lartë dhe konkurrenca e madhe

Elkofar shet në një industri me teknologji të lartë, duke konsideruar se pasijet e tilla shumë shpejtë zhvillohet. Ka mundësi që kompania ka nevojë të adaptohet shumë shpejtë me kërkesat në rritje të tregut, por mund të mos ketë burime për të adresuar këtë. Po ashtu Elkofar operon në një industri shumë konkurruese dhe shumë furnitorë mund të ndjekin konsumatorët e njëjtë që do të thotë se ka presion mbi çmimet. Siç u diskutua më sipër marzha operative e kompanisë është tashmë e ulët dhe zbritja në çmime mund të shkaktojë probleme të mëtutjeshme.

Mbështetja në konsumatorët kyç

Elkofar mbështet në vetëm 20 konsumator për të gjeneruar të hyra nga tregu vendor i cili treg gjeneron rreth 50% të të hyrave të kompanisë. Në një treg konkurrues, do të jetë e vështirë mbajtja e konsumatorëve pa i zbritur çmimet, që do të bëjnë presion të mëtutjeshëm në fitim. Çështja tjetër është se problemi me cilësinë tashmë mund të ketë shkaktuar ikjen e ndonjërit prej konsumatorëve pavarësisht veprimin e kompanisë për të zëvendësuar produktet.

Çështjet rregullatore

Rregullativa e re hyn në fuqi pas disa muajsh. Duket se fabrikat momentalisht nuk janë në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore prandaj ka filluar ndërtimi i vijave të prodhimit që do të jenë në pajtueshmëri. Kjo çështje shkakton rrezik domethënës të pajtueshmërisë që mund të qoq drejt hetimit nga agjencitë rregullatore dhe mund të rezultoj me gjoba e dënime si dhe reputacion të keq. Gjithashtu ka kosto shtesë të monitorimit dhe kosto për shpenzime kapitale.

Financimi shtesë – çështje me likuiditetin

Është marrë një kredi që përfaqëson 16.7% të pasurive gjatë vitit. Kjo është një shumë materiale që do të rrisë leverazhin e kompanisë dhe rritje të obligimit për të paguar interesin që është 1.2 milion në vit si dhe ripagesa e kredisë në të ardhmen. Kompania nuk duket se ka shumë para, me vetëm €130,000 para të gatshme dhe një mbiteheqje prej €2.5 milion, kapitali punues mund të

jetë problem afatgjatë i kompanisë. Koeficienti qarkullues dhe i shpejtësisë po ashtu tregojnë se kompania ka problem në kthimin e borxheve me kohë.

Profitabiliteti

Pasqyra drat e të ardhurave tregon se të hyrat kanë rënë me 9.4% dhe fitimi operativ ka rënë me 50%. Në përgjithësi kompania ka gjeneruar humbje për vitin actual. Në vitin 2015 kostot financiare nuk janë mbuluar nga fitimi operativ dhe duket se këto kosto ende nuk përfshijnë interesin e kredisë së re të cilat do të jenë €500,000 ($€30m \times 4\% \times 5/12$). Përfshirja e koston shtesë do të rrisë humbjen në €800,000. Ky mund të jetë tregue për problem me vijimësinë.

Ndrrimet në menaxhmentin kyç

Humbja e disa drejtorëve gjatë vitit është rrezik biznesor dhe kompania mund të humb aftësitë kryesore dhe përvojën. Mund të merr kohë deri sa drejtorët të zëvendësohen.

(ii) Rreziqet e anomalive materiale

Transaksionet në valutë të huaj – njohja fillestare

Shumica e bakrit importohet që çon në rrezik të trajtimi kontabël për transaksionet me valutë të huaj. Sipas SNK 21 Efektet e ndryshimeve në normat e këmbimit valutro, valuta e huaj në fillim duhet të njihet duke përdorur normën e datës së transaksionit ose normën mesatare nëse valuta nuk luhet në mënyrë domethënëse. Nëse kompania nuk përdorë këtë normë si duhet, kjo mund të shkaktojë shpenzime të pasakta, detyrime dhe stoqe të pasakta.

Transaksionet në valutë të huaj – fitimi dhe humbja nga këmbimi

Një rrezik tjetër është trajtimi kontabël i saldove në valutë të huaj në fund të vitit. Të pagueshmet në valutë të huaj duhet të ripërkthehen në fund të vitit sipas valutës në fund të vitit dhe duke njohur çfardo fitimi ose humbje nga transaksioni. Rreziku është se nëse ky ripërkthim nuk ndodhë në fund të vitit, mund të shkaktojë nën/mbi vlerësim të llogarive të pagueshme dhe shpenzimeve operative. Gjithashtu pagesat që janë bërë gjatë vitit nëse nuk janë përkthyer si duhet mund të shkaktojnë gabime në fitim dhe humbje nga këmbimi valuator.

Tërheqja e produkteve – stoqet e dala jashtë përdorimit

Ekziston një sasi e bakrit që duhet të sjellet në vlerën e saj të neto të realizueshme për shkak të ndryshkut dhe nuk mund të përdoret në pllaka elektronike. Stoqet duhet të vlerësohen sipas SNK 2, matja sipas koston ose VNR cilado që është më e ulët. Nëse stoqet nuk sjellen në VNR atëherë ato mund të jenë të mbivlerësuar në fund të vitit. Rreziku rritet edhe më tutje për shkak të pamundësisë së kompanisë të vërej me sy dëmtimet e bakrit por vetëm përmes testimit elektrik.

Tërheqja e produkteve – rimbursimi i konsumatorëve

Për shkak të produkteve të dëmtuara ka gjasë që disa konsumatorë të kërkojnë rimbursim të pagesave në vend të zëvendësimit të produktit. Nëse pagesa është kryer, kompania duhet të njeh një provizion për vlerën e rimbursimit. Nëse konsumatori nuk ka paguar ende për mallrat e dëmtuara, atëherë saldoja e llogarisë së arkëtueshme të konsumatorit duhet të shlyhet. Varësisht a ka paguar apo jo konsumatori gabimet në trajtimin kontabël të këtyre rimbursimeve mund të shkaktojë mbivlerësim të fitimeve në fund.

Financimi shtesë – kapitalizimi i vijës së re të prodhimit

Procesi i ri i prodhimit duket të jetë një shpenzim domethënës capital dhe është me rëndësi që kompania ta trajtojë atë në pajtueshmëri me SNK 16 Prona, impinatet dhe pajisjet si dhe SNK 32 Kosto e huamarrjes. Kosto financiare që shpërndahet direkt në këto makineri duhet të kapitalizohet përgjatë periudhës së ndërtimit të linjës së prodhimit dhe nëse nuk kapitalizohet atëherë pasuria joqarkulluese mund të jetë nënvlerësuar. Po ashtu ka rrezik që për shkak të presionit të fitimit, kompania të nënvlerësojë shpenzimet, kjo do të arrihej përmes trajtimit të zërave të shpenzimit si zëra capital dhe kështu të mbivlerësohet fitimi.

Rregulloret e reja – vlerësimi i fabrikave dhe vijave të prodhimit ekzistuese

Ka rrezik që vijat ekzistuese të prodhimit të jenë dëmtuar (humbje në vlerë). Për shkak të rregullores së re këto vija të prodhimit nuk do të përdoren prandaj kompania duhet të trajtojë ato në pajtueshmëri me SNK 36 Dëmtimi i pasurive. Sipas këtij standardi kompania duhet të ndërmer rishikime për dëmtimet e mundshme dhe të identifikoj shumën e rikuperueshme. Nëse nuk bëhet ky rishikim, pasuria mund të jetë e mbivlerësuar.

Financimi shtesë – matja dhe shpalosja e kredisë

Kredia e marr nga banka është një detyrim financiar i cili duhet të matet sipas SNRF 9 Instrumentat Financiar, i cili thekson se detyrimet financiare duhet të klasifikohen dhe maten sipas koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv (përveç nëse është vendosur më parë të përdoret vlera e drejtë). Ka rrezik që kosto e amortizimit nuk është aplikuar që do të thotë se kosto financiare nuk është paraqitur si akruale. Fakti që kosto financiare në draft pasqyrat financiare ka mbetur e njëjtë nga viti i kaluar do të thotë se ka nënvlerësim të koston financiare dhe detyrimeve. Po ashtu ka rrezik që shpalosjet nuk janë bërë sipas SNRF 7 Instrumentat financiar: Shpalosjet. Shënimet e pasqyrave financiare duhet të përmbajnë shpalosje narrative dhe numerime lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut dhe duke marr parasysh materialitetin e kredisë, ka mundësi që një shpalosje e tillë të jetë e nevojshme.

(iii) Çështjet etike

Menaxheri i auditimit të firmës Beri-Audit është duke u intervistuar për pozitën e shefit të kontabilitetit në Elkofar.

Kjo çështje krijon kërcënim ndaj pavarësisë. Sipas Kodit të Etikës së IFAC, familjariteti ose frikësimi mund të krijohen me rastin e punësimit të klienti i auditimit.

Kërcënimi i familjaritetit shkaktohet nga marrëdhënia e menaxherit të auditimit me kompaninë. Kjo mund të shkaktojë që ekipi i auditimit të humb objektivitetin, dështoj të sfidojë atë dhe të humb skepticizmin profesional. Gjithashtu anëtarët më të ri të ekipit të auditimit mund të frikësohen nga menaxheri. Ai gjithashtu është në dijeni për metodologjinë dhe procedurat e auditimit që janë zbatuar nga auditimet e mëparshme, që e bën më të lehtë ti anashkalojë ato procedura nëse përdoren edhe këtë vit.

Firma e auditimit duhet të sigurojë se menaxheri i auditimit të mbahet larg angazhimit për auditim të Elkofar dhe gjithashtu të mbahet larg nga aktivitetet biznesore tjera të firmës. Nëse menaxheri ende do të jetë afër aktiviteteve të firmës atëherë kërcënimi i pavarësisë është tepër i madh dhe do të jetë e vështirë të zvogëlohet me masa tjera mbrojtëse.

Çfardo pune që është kryer nga menaxheri i auditimit duhet të rishikohet pasi që mund të ketë kërcënim të vet-rishikimit. Pasi që planifikimit nuk është kryer ende, firma duhet të ketë kujdes që të zbatojë procedura të duhura të kontrollit të cilësisë.

Përfundimi

Auditimi i Elkofar duhet të konsiderohet si auditim me rrezik të lart për shkak të një numri të konsiderueshëm të rreziqeve biznesore dhe rreziqeve të anomalive materiale. Duhet të zhvillohet një strategji e auditimit për të zvogëluar rrezikun e përgjithshëm të auditimit si dhe duhet të respektohen procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë tërë auditimit. Përveç kësaj, çështja etike e menaxherit të auditimit duhet të paraqitet tek partneri i etikës së firmës sa më parë të jetë e mundshme.

Detyra 2

(a) Ju jeni menaxher në Loin Audit, përgjegjës për auditimin e Lala Shpk, një biznes që menaxhohet nga pronari dhe operon një zingjir të kafterive dhe restoraneve. Ky është auditimi i parë nga firma juaj për këtë kompani dhe auditimi është në process për vitin që përfundon me 31 mars 2016.

Seniori i auditimi ju ka dërguar shënimet e mëposhtme:

‘Gjatë auditimit të të hyrave kam vërjetur një gjë të çuditshme. Të hyrat e Lala Shpk, të cilat janë gati të gjitha në para të gatshme, kanë vlerën prej €5.5 milion në pasqyrat financiare draft.

Mirëpo, sistemi i kontabilitetit paraqet se të hyrat në para nga konsumatorët janë vetëm €3.5 milion. Kjo duket e çuditshme, prandaj kam pyetur Ana Shehun, shefen e kontabilitetit për këtë çështje. Ajo tha se Prenk Lala, pronari i kompanisë, merret me paranë dhe i regjistron inkasimet në ditar. Ana pyeti Prenkun për këtë çështje por ai refuzoi të jap përgjigje.’

‘Gjatë auditimit të parasë, kam vërjetur një pagesë prej €2 milion e realizuar përmes transferit bankar nga llogaria e kompanisë drejt një institucioni financiar jashtë vendit. Raporti bankar paraqet se transferi ishte autorizuar nga Prenk Lala por nuk kishte ndonjë dokumentacion mbështetës tjetër për këtë transfer. I alarmuar nga madhësia e këtij transferi dhe mungesa e dokumenteve mbështetëse, kam pyetur Prenkun për burimin e këtyre inkasimeve dhe arsyen e transferit. Ai nuk dëshiroi të jep përgjigje dhe u bë mjaft agresiv.’

Kërkohet:

- (i) **Diskutoni implikimet e rrethanave të mësipërme në shënimin e seniorit të auditimit; dhe (6 pikë)**
- (ii) **Shpjegoni natyrën e raportimit që duhet të bëhet nga seniori i auditimit në këtë rast. (3 pikë)**

(b) Ju po ashtu jeni përgjegjës për auditimin e Koko Shpk dhe aktualisht jeni duke rishikuar letrat e punës së auditimit për vitin që përfundon me 28 shkurt 2016. Në letrat e punës që kanë të bëjnë me pagat, juniori i auditimit ka komentuar si në vijim: ‘Janë shtuar disa punonjës të ri në listën e pagave të kompanisë, me pagesë gjithsej prej €125,000 (për të gjithë në total). Nuk shihet se ka pasur autorizim për këta emra shtesë në listën e pagave. Kur pyeta zyrtarin e pagave i cili kishte bërë këto ndryshime në listë, ai tha se nuk kishte nevojë për autorizim pasi që punonjësit e rinj janë punësuar vetëm përkohësisht. Mirëpo, kur kam diskutuar numrat e të punësuarve me menaxhmentin, ata theksuan se nuk kishin punësuar asnjë punëtor të ri gjatë vitit. Përveç testeve të planifikuara të kontrollit, nuk është kryer ndonjë punë tjetër në auditim.’

Kërkohet:

Lidhur me auditimin e pagave në Koko Shpk: Shpjegoni kuptimin e ‘skeptizmit profesional’, dhe rekomandoni veprimet e mëtutjeshme që duhet të ndërmerren nga auditori. (6 pikë)

(Gjithsej 15 pikë)

Zgjidhja

(a) (i) Rrethanat e përshkuara nga seniori i auditimit tregojnë se pronari i kompanisë është duke e përdorur kompaninë e tij të pastrojë para. Pastrami i parasë definohet si proces sipas të cilit kriminelët përpiqen të fshehin origjinën dhe pronësinë e të hyrave nga aktiviteti i tyre kriminal, duke lejuar kështu të kenë kontroll mbi ato të hyra dhe të mbulojnë në mënyrë ligjore burimin e të hyrave. Aktiviteti i pastrimit të parasë mund të jetë prej një veprimi të vetëm, që është pronësia mbi të paranë nga burimet e dyshimta kriminale deri te skema të sofistikuara që përfshijnë palë të shumëfishta dhe metoda të shumëfishta që trajtojnë pronat kriminale. Biznesi i Lala është kryesisht në para të gatshme, që e bën një mjedis ideal për ta legalizuar paranë e fituar diku tjetër të duket si e hyrë e biznesit. Duket se €2 milion para shtesë janë shtuar në të hyrat origjinale të biznesit. Fakti që vetë pronari i poston të hyrat në libra të kompanisë ngrit dyshime lidhur me ligjshmërinë e transaksioneve. Gjithashtu dyshimet rriten nga fakti se pronari ka refuzuar të shpjegojë natyrën e regjistrimeve kontabël. Pagesa e €2 milion përmes trasnaferit elektronik është në shumën e njejtë sa është paraja e postuar në ditar si e hyrë. Kjo është tregues se paraja është duke u pastruar. Pastruesit e parasë shpesh e lëvizin paranë jashtë shtetit për të larguar paranë nga burimi original dhe ta bëjnë gjurmimin më të vështirë. Reagimi i pronarit lidhur me pyetjen për burimin e parasë dhe transferin drejton në faktin se ka diçka për të fshehur sjellja e tij duket se ka mungesë të integritetit dhe këto fakte janë të mjaftueshme për firmën e auditimit nëse do të vazhdojë ta ketë këtë kompani si klient. Seniori i auditimit kishte reaguar si duhet mirëpo pyetja që i ka bërë pronarit mund ta ketë alarmuar atë për dyshimet që kanë auditorët për pastrimin e parasë. Ka rrezik që seniori i auditimit përmes këtij reagimi e ka informuar pronarin për pasojat dhe kjo mund të ketë ndikim në hetime. Shuma është materiale prandaj ka efekt edhe në auditim. i tërë angazhimi duhet të konsiderohet si auditim me rrezik të madh dhe të qaset me skepticizëm profesional. Firma duhet të konsideroj nëse është e përshtatshme të tërhiqet nga angazhimi.

(ii) Seniori i auditimit duhet ta diskutojë çështjen e auditorin përgjegjës dhe të informohen personat në firmën e auditimit për këshilla në rast të situatave të tilla. Firma e auditimit duhet të raportoj situatën tek organet përgjegjëse. Sipas ligjeve aktuale në Kosovë, të gjitha transaksionet që duken të dyshimta lidhur me pastrimin e parasë duhet të raportohen në Nësinë per Hetime Financiare dhe audiorët nuk kanë përjashtim.

(b) Termi skepticizëm profesional është i përkufizuar në SNA 200 Objektivat e përgjithshme të auditorit të pavarur dje kryerja e një auditimi në pajtueshmëri me SNA siç vijon: 'Një sjellje që përfshinë qëndrimin e vëmendshëm për kushtet që tregojnë anomali të mundhsme për shkak të gabimeve ose mashtrimeve dhe vlerësimin kritik të dëshmive të auditimit'.

Skepticizimi profesional do të thotë që auditori duhet të jetë i vëmendshëm ndaj dëshmive që janë kundërthënëse ose të pabesueshme dhe kushteve që mund të tregojnë ekzistencën e mashtrimit. Nëse nuk mbahet skepticizmi profesional, auditori mund të anashkalojë rrethanat dhe të përdorë procedurat të papërshtatshme të auditimit ose të arrijë në përfundime të papërshtatshme kur e vlerëson rezultatin e punës së auditimit. Si përmbledhje, ruajtja e skepticizmit profesional është e rëndësishme për të zvogëluar rrezikun e auditimit. Në këtë rast, juniori i auditimit nuk ka përdorur skepticizëm të duhur profesional kur ka përfutuar evidencë të auditimit. Së pari, besueshmëria e përgjigjes së mbikqyrësit të pagave duhet të vihet në pyetje. Pastaj duhet të kërkohet dëshmi mbështetëse dhe vërtetuese lidhur me emrat e rinj në listë që me të vërtetë janë të përkohshëm. Mungesa e autorizimit duhet të hetohet më tutje. Autorizimi është një kontroll i rëndësishëm për punësimin e punëtorëve të rinj, qofshin ata edhe të përkohshëm. Nëse është e saktë se kompania nuk kërkon autorizim për punëtorët e përkohshëm atëherë junior i auditimit duhet ta shënoj këtë si mangësi në kontrolle të brendshme dhe të raportohet në letrën e menaxhmentit. Gjithashtu duhet të hetohet dëshmia kontradiktore nga komentet e bëra nga menaxhmenti. SNA 500 Dëshmitë e auditimit thekson se nëse dëshmia e përfutuar nga një burim nuk është në konsistencë me burimin tjetër... auditori duhet të përcaktojë modifikimin ose

shtimin e procedurave të auditimit për të zgjidhur çështjen. Prandaj duhet të kryhen procedura shtesë për të përcaktuar cili nga burimet e dëshmive është më i besueshëm. Duhet të diskutohet mëtej me menaxhmentin për të qartësuar a janë rekrutuar punëtorë të tjerë gjatë itit. Në këtë rast ka rrezik se dikush ka futur persona fiktiv në listën e pagave prandaj auditori duhet të përfshirë procedura shtesë për të adresuar këtë rrezik. Duhet të rishikohen llogaritë bankare të punonjësve për tu siguruar se nuk janë fiktiv ose të ndonjë personi brenda kompanisë. Juniori i auditimi është dashur të diskutojë këtë çështje me menaxherin e auditimit për të kërkuar udhëzime të mëtejshme.

Detyra 3

(a) Pasqyrat financiare shpesh përmbajën saldo materiale të njohura sipas vlerës së drejt (fer). Për auditorët kjo çon në rrezik shtesë të auditimit.

Kërkohe:

Diskutoni deklaratën e mësipërme. (7 pikë)

(b) Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Popaj Shpk, një kompani prodhuese viti fiskal i të cilës përfundon me 31 dhjetor 2015. Në vitin e kaluar janë blerë disa prona investuese për të shfrytëzuar tepricën e fondeve të kompanisë dhe për të gjeneruar të hyra nga qiraja. Këto prona janë rivlerësuar në fund të vitit në pajtueshmëri me SNK 40 *Pronat Investuese* dhe janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë prej €8 milion. Pasuria gjithsej e kompanisë me 31 dhjetor 2015 ishte €160 milion. Kompania kishte angazhuar një vlerësuar të jashtëm për të rivlerësuar këto prona.

Kërkohe:

- (i) **Rekomandoni bisedat/pyetjet që duhet të bëni lidhur me vlerësuesit e jashtëm para se të mbështeteni në punën e tyre dhe shpjegoni arsyet e këtyre pyetjeve. (7 pikë)**
- (ii) **Identifikoni dhe shpjegoni procedurat kryesore të auditimit që duhet të kryhen në pronat e rivlerësuara investuese. (6 pikë)**

(Gjithsej 20 pikë)

(a) Vlera fer dhe rreziku i auditimit

Matja e një pasurie ose detyrime sipas vlerës fer mund të jetë kërkesë e SNRF ose zgjedhje e bërë nga vet entitetit. Shembuj të zërave që maten sipas vlerës fer përfshijnë pronat dhe instrumentat financiar. SNRF 13 matja sipas vlerës fer përmban udhëzime të gjera në këtë fushë.

Zërat që maten sipas vlerës fer shpesh kanë saldo material në pasqyrën e pozicionit financiar prandaj kërkojnë nga auditori të grumbulloj dëshmit të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nëse janë bërë në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit. Udhëzues për auditorët është SNA 540 Auditimi i vlerësimeve kontabël, përfshirë vlerësimet kontabël për vlerën fer dhe shpalosjet përkatëse.

Përmes njohjes me entitetin dhe mjedisin e tij nga SNA 315, auditori fiton njohuri mbi saldot të cilat maten sipas vlerës fer dhe pastaj e vlerëson ndikimin e tyre në strategjinë e auditimit dhe rrezikun.

Rreziku i auditimi është product i rrezikut të vetvetishëm, rrezikut të kontrollit dhe rrezikut të moszbulimit.

Rreziku i vetvetishëm

Matjet sipas vlerës fer janë vetvetiu subjective pasi që përfshijnë bërjen e vlerësimeve bazuar në supozime. Menaxhmenti mund të mos ketë përvojën e duhur për të bërë këto supozime. Supozimet po ashtu mund të manipulohen nga individët për të përfutur vlerën më të madhe në pasqyrat financiare.

Llogarija e vlerës fer është komplekse për shumicën e saldoeve, psh llogaritjet aktuariale që përdoren në vlerësimin e fondeve pensionale. Kjo e bën vetvetiu më të vështirë për tu audituar dhe me mundësi të gabimeve për shkak të llogaritjeve komplekse.

Mirëpo, jo të gjitha saldot me vlerë fer janë komplekse dhe subjektive, psh vlerësimi i pasurive të cilat shiten dhe blihen në treg të hapur. Ky lloj i saldosh nuk do të rrit rrezikun e auditimit pasi që vlera e tregut mund të vërtetohet lehtë.

Rreziku i kontrollit

Matjet sipas vlerës fer nuk janë transaksione rutinore dhe ka mundësi të ndodhin një herë në vit. Prandaj ka mundësi që bien jashtë sistemit normal të kontrollit. Kjo e rrit mundësin që kontrollet të mos jenë mjaftueshëm të forta për këto transaksione.

Mirëpo pasi që saldot me vlerë fer janë material, ka gjasë që menaxhmenti të i monitorojë më për së afërmi për të zvogëluar kështu rrezikun e kontrollit.

Rreziku i moszbulimit

Rreziku i moszbulimit do të zvogëlohet duke bërë planifikim të duhur të auditimit, ka rrezik se ekipi i auditimit të mos ketë njohurinë dhe përvojën përkatëse për të audituar zëra me vlerën fer dhe kështu të mbështeten në punën e ekspertëve të vlerësimit.

Përfundimi

Një numër i madh i saldove materiale të matura sipas vlerës fer e rrit rrezikun e auditimit në pasqyrat financiare, por jo nuk është gjithmonë e vërtetë. Jo të gjitha saldosh do të përmbajnë anomaly material prandaj duhet të vlerësohet rreziku në secilën saldo individuale.

(b) (i)

Pyetja	Arsyeja
Cila është certifikata profesionale e vlerësuesit? A është vlerësuesi anëtar i ndonjë organizate profesionale? A ka standarde ose ligje/rregullore të zbatueshme për vlerësime? Cilat supozime dhe metoda janë përdorur nga vlerësuesi dhe a janë ato të arsyeshme? Natyra e të dhënave të brendshme dhe të jashtme të përdorura nga vlerësuesi A ka dëshmi për reputacionin e vlerësuesit, psh referencë profesionale.	Për të përcaktuar kompetencën e vlerësuesit dhe besueshmërin e vlerësimit
A ka licencë vlerësuesi për të vlerësuar prona investuese?	Për të përcaktuar nëse vlerësuesi ka përvojën e duhur
Çfarë përvoje ka vlerësuesi në vlerësimin e pronave të ngjashme dhe njohjen me vlerën fer	Për të siguruar se vlera fer është arritur duke përdorur metoda në pajtueshmëri me SNK 40 Pronat investuese
A është vlerësuesi i pavarur nga entiteti që e ka angazhuar A ka ndonjë interes financiar te entiteti	Për të përcaktuar objektivitetin e vlerësuesit dhe nëse ai është i pavarur nga entiteti që e ka angazhuar
A është tarifa e pranuar nga vlerësuesi e arsyeshme dhe sipas çmimit të tregut	Nëse tarifata nuk janë sipas vlerës së tregut (psh shumë të larta) pavarësia e vlerësuesit mund të jetë kërcënuar për të ofruar rezultate të pritshme nga entiteti

(ii) **Procedurat**

- Inspektimi i udhëzimeve të shkruara që i janë dhënë vlerësuesit të cilat duhet të përfshijnë objektivën dhe shtrirjen e punës, përdoruesit e raportit etj
- Konsiderimi i supozimeve dhe metodave të përdorura nga vlerësuesi për të siguruar se ato janë të arsyeshme bazuar në dëshmitë tjera të auditimit dhe nga njohuria e mëparshme e kompanisë
- Vlerësimi i metodës së përdorur për të matur pronat sipas vlerës fer nëse është në pajtueshmëri me SNK 40
- Ekzaminim i raportit të vlerësimit për të siguruar se secila pronë është vlerësuar në mënyrë konsistente dhe se data e vlerësimit është sa më afër fundit të vitit.
- Inspektimi fizik i pronave të vlerësuar për të siguruar se gjendja e tyre është në pajtueshmëri me raportin e vlerësimit
- Inspektimi i dokumenteve të blerjes së pronave për të siguruar se rivlerësimi i bërë në vitin e blerjes nuk dallon shumë nga çmimi blerës
- Rishikimi i ngjarjeve pas datës së raportimit për ndonjë dëshmi shtesë lidhur me vlerësimin e pronave investuese
- Letrat e përfaqësimit lidhu me arsyeshmërinë e supozimeve të përdorura

Detyra 4

(a) Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Motori Shpk, një kompani që dizajnon dhe prodhon pjesë të motorave. Auditimi i pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015 është afër përfundimit dhe ju jeni duke i rishikuar letrat e punës të seksionit të hipotezës së vijimësisë në dosjen e auditimit. Pasqyrat financiare paraqesin një humbje prej €500,000 (2014 - fitim prej €760,000) dhe gjithsej pasuri prej €13.8 milion (2014 - €14.4 milion).

Seniori i auditimit ka përgatitur një shënim për ju:

'Kam kryer procedura analitike në pasqyrat financiare. Koeficienti qarkullues është 0.8 (2014 - 1.2), koeficienti i shpejtësisë është 0.5 (2014 - 1.6). Pasqyrat menaxheriale të fundit tregojnë se këto koeficient janë përkeqësuar edhe më shumë që nga fundi i vitit dhe tani kompania ka një saldo të parasë prej vetëm €25,000. Burimi ka një kredi afatgjatë të papaguar në vlerë €80,000 me disa kushte të cilat theksojnë se nëse koeficienti qarkullues bie nën 0.75, kredia mund të ndërpritet menjëherë nga banka.'

Ju po ashtu jeni në dijeni se produktet më të shitura të Burimi Shpk teknikisht janë bërë të papërdorshme/jasht-mode gjatë vitit 2015 pasi që konsumatorët tani janë orientuar në pjesë motori që janë më ekologjike. Historikisht këto produkte kanë gjeneruar 45% të të hyrave të kompanisë. Si përgjigje ndaj preferencave të konsumatorëve, kompania ka shpenzuar €1.3 milion në dizajnimin e produktit të ri që është më ekologjik dhe produkti pritet të lansohet në korrik 2016 dhe do të reklamohet si produktet miqësor ndaj ambientit.

Është përgatitur një parashikim i parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016 dhe bazuar në supozimet e bëra, sadoja përfundimtare e parasë do të rritet në €220,000. Supozimet përfshijnë:

1. Lansimi i suksesshëm i produktit të ri
2. Shitja e makinerisë që ishte përdorur për të prodhuar produktin e vjetër, që do të gjeneron të hyra në para prej €50,000, kjo do të ndodhë në qershor 2016
3. Një zvogëlim në koston e pagave prej 15% i shkaktuar nga ndërprerja e kontratave të punëtorëve për vijën e prodhimit të produktit të vjetër
4. Pranimi i një granti qeveritar prej €30,000 nga ministria që përkrah zhvillimin e produkteve ekologjike, që panifikohet të merret në korrik 2016.

Kërkohe:

- (i) **Identifikoni dhe shpjegoni çështjet që hedhin dyshim mbi aftësinë e kompanisë Burimi të vazhdojë operimin sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)**
- (ii) **Shpjegoni dëshmitë e auditimit që prisni të gjeni në dosjen e auditimi lidhur me parashikimin e parasë. (8 pikë)**

(b) Pas përfundimit të rishikimit të dosjes së auditimit, ju keni arritur në përfundim se përdorimi i hipotezës së vijimësisë është i përshtatshëm, por ka dyshime domethënëse në aftësinë e kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë. Ju keni këshilluar komitetin e auditimit të kompanisë se nevojitet një shënim në pasqyra financiare për të shpjeguar dyshimin domethënës për hipotezën e vijimësisë. Komiteti i auditimit është duke ngurruar të përfshijë një shënim të tillë për shkak të frikës se kjo do të shfaqte problemet e kompanisë dhe do të shkaktonte vështirësi tjera financiare, por ishin pajtuar se një shënim i shkurt do të përfshihej.

Kërkohe:

Sa i përket shënimit mbi hipotezën e vijimësisë që do të përfshihet në pasqyrat financiare të Burimi Shpk, diskutoni implikimet në raportin e auditimit dhe paraqitni veprimet e mëtutjeshme që duhet të kryhen nga auditori. (6 pikë)

(Gjithsej 20 pikë)

Zgjidhja

(a) (i) Performanca

Rënia nga fitimi i mirë në një humbje prej €0.5 milion. Kjo duket se është rezultat nga dalja jashtë mode e produktit kryesor dhe humbja e 45% të të hyrave.

Duket se profitabiliteti do të bie edhe më shumë në vitet e ardhshme si efekt i moshtijes së produktit kryesor.

Edhe pse kompania ka zëvendësimin, çfardo produkti i ri do të merr kohë për të fituar pjesën e duhur të tregur dhe nu ka shumë mundësi që ky trend i rënies do të kthehet në të kundërtën shumë shpejtë.

Likuiditeti

Përkeqësimi i koeficientëve të qarkullimit dhe të shpejtësisë trgojnë për një rënie të vazhdueshme të likuiditetit. Me detyrimet qarkulluese që janë më të mëdha se pasuritë qarkulluese kompania nuk do të ketë mundësi të paguaj borxhet kur ju vjen koha. Nëse nuk paguhen furnitorët atëherë ata mund të kufizojnë furnizimin.

Përveç kësaj, nëse ka stoqe të produktit të vjetër atëherë duhet të njihen humbje nga dëmtimet dhe kështu koeficientët do të zbresin edhe më shumë.

Pozita e parasë

Saldoja e parasë së gatshme të kompanisë prej €25,000 është shumë e ulët që përfaqëson vetëm 0.2% të pasurive totale. Ka pak mundësi që kompania të mbijetojë me aq pak para. Nuk dihet nëse kompania ka mbitërheqje që mund të ndihmonte të mbijetonte për së paku edhe disa kohë.

Kushtet e kredisë

Pasi që koeficientët e qarkullimit dhe shpejtësisë kanë rënë në krahasim me vitin e kaluar, ka mundësi që kushtet e kredisë tashmë janë shkelur. Nëse tërhiqet kredia nga banka, paraja ekzistuese nuk do të jetë e mjaftueshme për të paguar atë.

Kompania mund të duhet të shes pasuri tjera për të paguar kredinë.

Lansimi i motorit të ri

Mungesa e kapitalit qarkullues të kompanisë do të bënte të vështirë zhvillimin e produktit të ri dhe lansimin e tij, që do të ishte një rrezik i madh për hiptezën e vijimësisë.

(ii) Dëshimitë

- Përputhja e parasë në fillim ne pasqyrat financiare të audituara për të siguruar saktësinë e shifrave
- Rillogaritja e saktësisë matematikore të parashikimit të parasë
- Rishikimi i rezultateve të hulumtimit të tregut për produktin e ri ekologjik, për të siguruar se supozimet lidhur me lansimin e suksesshëm janë të përshtatshme
- Diskutimi i progresit të bërë në zhvillimin e produktit ekologjik me ekspertin teknik, për të vlerësuar mundësinë e lansimit të suksesshëm
- Rishikimi i korrespondencave me konsumatorët për të vlerësuar interesin e tyre për të blerë dhe porositur produktin e ri
- Rishikimi i dokumentacionit të shitjes lidhur me shitjen e pajisjeve për të konfirmuar se €50,000 janë të arritshme
- Inspektimi fizik i fabrikës dhe pajisjeve që do të shiten për të vlerësuar kushtet dhe mundësinë e shitjes

- Rishikimi i paralajmërimeve të bëra për largimin nga puna për të konfirmuar numrin e punonjësve që do të ndikohen
- Testimi përmes mostrës së punonjësve që do të largohen nga puna, duke përputhur shumën që do të paguhet me të dhënat nga burimet njerëzore, për të siguruar saktësinë e parashikimit
- Rishikimi i aplikimit të bërë te qeveria për të konfirmuar shumën e grantit. Konfirmimi i korrespondencave nga qeveria për pranimin e €30,000.
- Pajtueshmëri e rrjedhës së parasë nëse është konsistente me fitimin dhe parashikimet tjera të përgatitura nga menaxhmenti
- Konfirmimi se supozimet e bëra në përgatitjen e parashikimit të parasë janë konsistente me njohurinë e auditorit për biznesin dhe qëllimet e menaxhmentit
- Krahasimi i parashikimit të parasë së gatshme për periudhën e ardhshme me pasqyrat menaxheriale, për të siguruar saktësinë e parashikimit
- Procedurat analitike të përfshira në parashikimin e rrjedhës së parasë, psh, kategoritë e shpenzimeve dhe hulumtimi i zërave që mund të jenë shmangur

(b) SNK 1 Prezentimi i pasqyrave financiare kërkon shpalosje për situatat kur ka dyshime domethënëse mbi hipoteën e vijimësisë. Një shënim i shkurtër ka gjasë të jetë i pamjaftueshëm pasi që shënimi duhet të përshkruaj arsyet për dyshimin së bashku me planet e menaxhmentit për të dalur nga kriza.

Shpalosja e mjaftueshme

Në këtë rast është në pajtueshmëri me SNK 1 prandaj pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali material. Në këtë rast auditori do të përfshij një paragraph për theksimin e çështjes por opinion nuk do të ndryshojë.

Auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me modifikimin e raportit të auditorit.

Shpalosja e pamjaftueshme

Në këtë rast ka anomaly material sa i përket SNK 1. Pyetja për auditorin është nëse anomalia është vetëm material apo përhapëse. Në rastin e parë auditori duhet të jep opinionin me rezervë ndërsa në rastin e dytë të jep opinion kundër.

Në të dy rastet duhet të përfshihet një paragraph i bazës së opinionit me rezervë/kundër dhe dot ë përshkruaj arsyet e modifikimit të opinionit. Ky paragraph vendoset para paragrafit të opinionit.

Auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me modifikimin e raportit të auditorit.

Detyra 5

Motobujku ShA është kompani që prodhon traktorë dhe makineri tjera bujqësore. Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Motobujku dhe jeni duke rishikuar letrat e punës së auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015. Pasqyrat financiare draft paraqesin të hyra prej €10.5 milion, fitim para tatimit prej €3.2 milion dhe pasuri gjithsej prej €45 milion.

Seniori i auditimi ju ka lënë shënimin në vijim:

Lizingu

Në qershor 2015, Motobujku nënshkroi kontratën për pesë lizingje financiare për tokë dhe ndërtesa. Lizingjet janë kapitalizuar dhe pasqyra e pozicionit financiar përmban pasuritë me lizing të klasifikuara si pasuri joqarkullues në vlerë prej €3.6 milion dhe lizingu financiar i pagueshëm prej €3.2 milion i paraqitur si detyrim që duhet paguar pas më shumë se një viti.

Pasuritë financiare

Pasuritë joqarkulluese përfshijnë pasuri financiare në vlerë prej €1.26 milion. Një shënim në pasqyra financiare përshkruan këto pasuri financiare si investime të klasifikuara sipas 'vlerës fer' dhe investimet janë përshkruar në shënim si 'të mbajtura për shitje'. Këto investime janë të gjitha aksione në një kompani të listuar. Një fitim prej €350,000 është njohur në fitimin neto nga rivlerësimi i këtyre investimeve.

Kërkohet

(a) Gajtë rishikimit tuaj të letrave të punës, komentoni mbi çështjet që duhet të konsideroni dhe tregoni evidencën e auditimit që prisni ta gjeni lidhur me:

- | | |
|--------------------------|----------|
| (i) Lizingu | (9 pikë) |
| (ii) Pasuritë financiare | (6 pikë) |

(Gjithsej 15 pikë)

Zgjidhja

(a) (i) Çështjet që duhet konsideruar

Materialiteti

Të dyja edhe pasuritë joqarkulluese dhe detyrimi për lizingun financiar janë material për pasqyrat financiare pasi që përfaqësojnë 8% dhe 7.1% përkatësisht të pasurive gjithsej.

Trajtimi kontabël

- Nëse lizingjet janë klasifikuar si duhet si lizingje financiare sipas SNK 17
Pohimi se lizingu është financiar do të thotë se në substancë janë pasuri e jo shpenzim. Kjo do të thotë se kompania ka rrezikun dhe shpërblimin e pronësisë përfshirë:
 - Përgjegjesinë për riparime dhe mirëmbajtje
 - Transferimin e titullit ligjor në fund të kontratës për lizing
 - Lizingu është për pjesën më të madhe të jetës së pasurisë
 - Vlera e tanishme e pagesave minimale është vlera domethënëse e pasurisë
- Lizingu rezulton me kosto financiare që llogaritet duke përdorur metoda aktuarile.
- Lizingu është për tokë dhe ndërtesa. Sipas SNK 17 vetëm elementi i lizingut për ndërtesa mund të kapitalizohet, pasi që lizingu për tokë është gjithmonë lizing operativ. Lizingu duhet të ndahet në dy elemente, lizingu për tokë dhe ai për ndërtesa.

Dëshmitë e auditimit

- Një kopje e llogaritjeve nga kompania për lizingjet financiare
- Kontrollimi i mbledhjeve dhe llogaritjeve në tabelë
- Në mënyrë që të verifikohet se lizingjet janë klasifikuar si duhet, të rishikohet kontrata për lizing dhe indikatorët për bartjen e rrezikut dhe përfitimeve, siç janë:
 - Kompania është përgjegjëse për riparimet dhe mirëmbajtjen e pasurive
 - Tituli ligjor transferohet në fund të kontratës për lizing
 - Konfirmimi nëse lizingjet janë për pjesën më të madhe të jetës së përdorimit të pasurisë
 - That Robster is responsible for repairs and maintenance of the assets
- Rillogaritja e kostove financiare që ngarkohen në fitim dhe humbje
- Përputhja e normave të interesit të përdorura në marrëveshjet për lizing
- Rillogaritja e shpenzimit të zhvlerësimit që ngarkohet në pasuritë joqarkulluese
- Verifikimi se elementi i tokës është klasifikuar si lizing operativ
- Rillogaritja e shpenzimeve të lizingut operativ sipas metodës drejtvizore përgjatë afatit të lizingut

(ii) Çështjet që duhet konsideruar

Materialiteti

Pasuria financiare prej €1.26 milion është materiale sepse paraqet 2.8% të pasurive. Fitimi prej €350,000 është materialer se paraqet 10.9% të fitimit para tatimit.

Trajtimi kontabël

- SNRF 9 Instrumentat financiar përcakton kategoritë në të cilat një instrument financiar duhet të klasifikohet së bashku me trajtimin e përshtatshëm kontabël. Klasifikimi fillestar i pasurive financiare si 'investime të mbajtura për shitje' është e rëndësishem pasi që paraqet mënyrën e trajtimit në kontabilitet e që është, sipas vlerës fer. Kjo do të thotë se duhet të matet sipas vlerës fern e fund të vitit dhe njohja e çfardo fitimi ose humbje direkt në PA.

- Pasuria prandaj është blerë për tu shitur në një periudhë të shukrtër dhe duhet të jetë pjesë e portfolios së përgjithshme të instrumentave që menaxhohen së bashku me qëllim të shitjes.

Dëshmitë e auditimit

- Një tabelë që tregon investimet që mbahen në këtë kategori sipas vlerës fer
- Harmonizimi i vlerës fer me dëshmitë e jashtme siç është çmimi i tregut
- Rillogaritja e fitimit ose humbjes nga lëvizja e përgjithshme në vlerën fer përgjatë vitit
- Rishikimi i kontrolleve të brendshme dhe procedurave të ndjekura nga departamenti i shitjes. Testimi për të konfirmuar detajet (sasi, datat, etj) që janë paraqitur në tabelë.
- Procedurat analitike për të konfirmuar se ka një portfolio të investimeve që tregtohen shpesh me qëllim të fitimit afatshkurt. Vërtetimi me rishikim pas fundit të vitit.